

RIFINITURA



FINOTEC

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	25 KG	3.7kg/m ² për 3mm trashësi

PËRSHKRIM

Fino e bardhë, me bazë çimento për mure të brendshme, tavane dhe fasada. I përshtatshëm për të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere të cilat nuk kanë karakteristike fleksibilitetin e lartë .. I papërshtatshëm për t'u vendosur direkt mbi bazamente me bazë gipsi apo te lyera me pare me boje.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret mbi të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere dhe gëlqere-çimento, si laçra me mbushje tradicionale dhe me laçra të parapërgatitur. Shtresë me një ose dy duar për rrafshimin e tavaneve, mureve të brendshme dhe të jashtme. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë dhe kohë tharje optimale.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Bazamentet me aftësi të lartë thithje duhet të lagen paraprakisht përpara aplikimit të produktit.





APLIKIMI

Përzieri me një përzierës elektrik 6.5-7 litra ujë me një thes 25 kg FINOTEC në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni produktin në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzieri përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me mallë dhe bëni nivelimin e saj në një trashësi prej 3mm. Pas 10-15 minutash fërkojeni sipërfaqen me përdaf derisa të nxirrni kokrrizën. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Aplikimi i bojës: 20 ditë
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	pH i përzierjes: 13
Ngjyra: E bardhë	Granulometria: 0.7 mm
Konsumi: 3.7 kg/m ² (3mm trashësi)	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Ruajtja: Ne paleta druri	Forca në shtypje: 2.5 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta dry	Forca në përkulje: 1.1 N/mm ²
Masa vëllimore: 1.4-1.5gr/cm ³	Thithja e ujit: WO
Sasia e ujit: 6.5-7 litra ujë per 25 kg produkt	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class
Mënyra e aplikimit: Nji ose dy duar	



Kujdes! NUK rekomandohet aplikimi i finos ne suportte me fleksibilitet te larte si sistemi kapot apo produkte te tjera fleksibel , ne siperfaqe te paqendrueshme ose ne disnivele te medha . ! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose persheptim ne tharje te produktit). Mos e perdorni ne:

- Suporte druri,metali, PVC apo siperfaqe te tjera jo me baze cimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.